



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

**th ë r r e t**

mbledhjen e **pestë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **27.06.2023** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. “UÇK”, nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozimvendimi për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit;
3. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit nr. 01-060/01-117700/23, të dt. 08.06.2023, për shkarkimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës;
4. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit nr. 01-060/01-117701/23, të dt. 08.06.2023, për caktimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës;
5. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-400/01-69255/23, të dt. 03.04.2023, për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;
6. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026 (KAB);
7. Propozimi i Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë;
9. Propozimplani lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2023-2026;
10. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Llukar” në Prishtinë;

11. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Busi të Prishtinës;
12. Propozimvendimi për subvencionimin e fondacionit "Robin Haxhi Krasniqi", për organizimin e ndeshjes së boksit profesionist ndërkombëtar;
13. Propozimvendimi për subvencionimin e personave fizikë dhe juridikë, të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje 1 (një) qen, apo më shumë;
14. Raporti vjetor i punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
15. Pyetje dhe përgjigje;
16. Të ndryshme.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-060/01-119426/23, më 12.06.2023

**KRYESUESI I MBLEDHJES SË KUVENDIT**  
Ajet Brajshori

